


Bazuar në MpB të nënshkruar mes IADK-së dhe Komunës së Vushtrrisë, të datës 11.03.2014, paragrafi: II. Bashkëfinancimin e projekteve të "IADK"-së në investimet direkte në sektorin e bujqësisë, pika e parë ("Komuna e Vushtrrisë së bashku me IADK-në do t'i kordinojnë investimet në sektorin e bujqësisë), dhe pika e tretë ("Komuna e Vushtrrisë" së bashku me "IADK"-në do të përzgjedhin projektet për bashkëfinancim të cilat do të detajohen në aneks I edhe për vitet e ardhshme deri në 2018 dhe do t'i bashkëngjiten kësaj MpB ku "Komuna e Vushtrrisë" në fillim të çdo viti kalendarik do të nënshkruaj anekset përkatëse), të dy palët pajtohen për të nënshkruar:

ANEKS II për vitin 2018



Bashkëpunimi dhe kontributi nga IADK me donator në Vushtrri

IADK do të zbatoj projektin "*Përkrahja e fermerëve të vegjël me pajisje dhe promovimi i energjisë së ripërtërishme*" financuar nga *Bread for the World 2018- 2019*, përmes së cilit do të përkrahen me grante dy target grupe të rinjëve, si janë:

1. Të diplomuarit në Fakultetin e Bujqësisë, të cilët kanë kushte për tu marrë me veprimtari bujqësore, jetojnë në zona rurale, janë të rinjë me moshë deri në 35 vjeç, dhe shprehin interesim dhe gadishmëri për tu marrë me aktivitete bujqësore;
2. Fermerët e rinjë me moshë nga 18-35 vjeç, të cilët janë entuziast për tu marrë me bujqësi, kanë kapacitet për të zhvilluar veprimtari bujqësore, jetojnë në zona rurale dhe janë në lista të pritjes për përkrahje nga IADK, të cilët nuk janë përkrahur në projektet e mëhershme;

Me këto grante në Komunën e Vushtrrisë do të përkrahen deri 20 përfitues, nëse i plotësojnë kriteret e planifikuara me projekt.

Në kuadër të projektit do të bëhen edhe disa investime në objektin e IADK-së, si janë:

- Investimi në vendosjen e paneleve solare në çatin e objektit, për të prodhuar energji solare, e cila do të përdoret për nevoja të IADK-së, ndërsa teprica do të zbrazet në rrjetin e shpërndarjes në KEK.
- Investimet në pajisjet kompjuterike dhe ormana e tavolina të punës për zyret e IADK-së;
- Investimet në kompletimin e hapsirës me pajisje për demonstrim të përpunimit të prodhimeve bujqësore me grupet e grave;
- Furnizimi me një Kombi për nevoja të IADK-së;

IADK po ashtu është duke zbatuar projektin "*Mbështetja e zinxhirit të vlerave të Bimëve Mjekësore Aromatike (BMA) përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimit të eksportit*", përmes së cilit do të përkrahen fermerët që merren me grumbullimin dhe kultivimin e bimëve mjekësore aromatike, e të cilët do të përkrahen në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese në këtë sektor.

Ky projekt do të zbatohet gjatë vitit 2018-2020 dhe së paku 20 fermerë do të përkrahen gjatë këtyre tri viteve, në rast të përmbushjes së kriterëve të selektimit.

Bashkëpunimi dhe kontributi nga Komuna e Vushtrrisë ne projekte

- “Komuna e Vushtrrisë” në bazë të mundësive buxhetore do të kontribuoj në bashkëfinancimin e projekteve në përkrahje të të rinjëve të diplomuar në drejtimin e bujqësisë, fermerëve dhe të rinjëve që do të përkrahen me grante;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të ndihmoj IADK-në në marrjen e pëlqimit për vendosjen e paneleve solare dhe procedurave tjera që nërlidhen me prodhimin dhe shkëmbimin e energjisë solare
- Përzgjedhja e përfituesve atje ku eshte e mundur do të bëhet nga komisioni i përbashkët i IADK-së dhe “Komuna e Vushtrrisë”, dhe kontratat për përfitim të projektit do të nënshkruhen nga tri palët (IADK, Komuna dhe përfituesi);

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv

Vushtrri 14/09/ 2018



Komuna e Vushtrrisë

Xhafer Tahiri
Kryetar

Vushtrri 14.09 2018



Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

Është jetojmë nga loba dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadc.org
Tel: 049777046 & 044777036
Web: www.iadc.org